



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
AUTORITETI PORTUAL DURRËS**

**PORTI I RI TREGTAR I INTEGRUAR I DURRËSIT NË
PORTO ROMANO - FAZA I**

Vëllimi IV

**Shtojca 28. Kushtet e Përgjithshme dhe Kushtet e Veçanta
të Kontratës**

Shtojca 28. Kushtet e Përgjithshme dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës¹

Shtojca 28. Kushtet e Përgjithshme dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës

Shtojca 28.1 Kushtet e Përgjithshme

Shtojca 28.2 Kushtet e Veçanta Pjesa A – Të dhënat e Kontratës

Shtojca 28.3 Kushte të Veçanta Pjesa B – Dispozita të Veçanta

Shtojca 28.4 Formularët

Formulari A: Formulari i Marrëveshjes së Kontratës

Formulari B: Garancia e Kompanisë Mëmë

Formulari C: Sigurimi i Kontratës–Kërkesa e Garancisë

Formulari D: Garancia e Paradhënies

Formulari E: Garancia me Mbajtjen e Parave

Formulari F: Marrëveshja për Shmangien e /Gjykimin e Mosmarrëveshjeve

¹ Kushtet e kontratës mund t'i nënshtrohen ndryshimeve gjatë procesit të negociatave të kontratës.

Shtojca 28.1 Kushtet e Përgjithshme

Kushtet e Kontratës përfshijnë pjesët e mëposhtme, përkatësisht:

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Kushtet e Veçanta Pjesa A – Të Dhënat e Kontratës

Kushtet e Veçanta Pjesa B – Dispozita të Veçanta

Kushtet e Kontratës përfshijnë "Kushtet e Përgjithshme", të cilat janë pjesë e "Kushteve të Kontratës për Ndërtim" Botimi i dytë; 2017 duke përfshirë Ndryshimet Botimi nr.1 – Dhjetor 2018, ERRATA në Kushtet e Kontratës për Ndërtim të FIDIC, Botimi i Dytë 2017, Ndryshimet Botimi nr. 2 – Qershor 2019 ERRATA në Kushtet e Kontratës për Ndërtim të FIDIC, Botimi i dytë 2017 dhe Ndryshimet Botimi nr. 3 – Nëntor 2022. Ndryshime në Kushtet e Kontratës për ndërtim të FIDIC për punime ndërtimi dhe punime inxhinierike, të projektuara nga punëdhënësi, Botimi i dytë, 2017, botuar nga Federation Internationale Des Ingénieurs - Conseils (FIDIC), të Dhënat e Kontratës (Kushtet e Veçanta – Pjesa A), dhe "Dispozitat e Veçanta" në vijim (Kushtet e Veçanta - Pjesa B) të cilat përfshijnë ndryshimet dhe shtesat në këto Kushte të Përgjithshme.

Kopje të Kushteve të Kontratës FIDIC mund të merren nga:

Sekretariati i FIDIC

World Trade Center II

PO Box 311

Geneva

Switzerland

www.fidic.org

Shtojca 28.2 Kushtet e veçanta Pjesa A – Të dhënat e Kontratës

Nën-klauzola	Të dhënat që duhen dhënë	Të dhënat
1.1.20	Aty ku Kontrata e lejon Fitimin Kosto Plus, përqindja e fitimit duhet t'i shtohet Kostos	5%
1.1.27	Periudha e Njoftimit të Defekteve (PNjD) Punime dragimi Pjesa e mbetur e punimeve	Asnjë ditë 730 ditë
1.1.31	Emri dhe adresa e punëdhënësit	Autoriteti Portual Durrës Rruga Tregtare, Lagjja Nr. 1, Durrës Shqipëri
1.1.35	Emri dhe adresa e inxhinierit	
1.1.84	Koha e përfundimit	1220 ditë
1.3 (a) (ii)	Metodat e miratuara të transmetimit elektronik	E-mail
1.3 (d)	Adresa e Punëdhënësit për komunikime	Autoriteti Portual Durrës Rruga Tregtare, Lagjja Nr. 1, Durrës Shqipëri
1.3 (d)	Adresa e Inxhinierit për komunikime	
1.3 (d)	Adresa e Kontraktorit për komunikime	
1.4	Kontrata do të rregullohet nga ligji i	Republikës së Shqipërisë
1.4	Gjuha mbizotëruese	Angleze
1.4	Gjuha e komunikimeve	Anglisht me përkthim shqip
1.8	Numri i kopjeve shtesë fizike të Dokumenteve të Kontraktorit	4
1.15	Përgjegjësia totale e Kontraktorit ndaj Punëdhënësit bazuar apo lidhur me Kontratën	

2.1	Pas marrjes së Letrës së Pranimit, Kontraktorit do t'i jepet e drejta e aksesit dhe posedimit të: ✓ të gjithë kantierit brenda ☐ pjesëve të kantierit si më poshtë: pjesa:.....ditëve pjesa:.....ditëve pjesa:.....ditëve	Për t'u vendosur ditëve ditëve ditëve
2.4	Rregullimet financiare të Punëdhënësit	Jo e zbatueshme
4.2	Sigurimi i Kontratës (si përqindje e Shumës së Pranuar të Kontratës në Valuta) Përqindje Monedha	10% Lekë
4.7.2	Periudha për njoftimin e gabimeve në artikujt e referencës	28 ditë
4.19	Periudha për pagesën e shërbimeve komunale të përkohshme	Jo e zbatueshme
4.20	Numri i kopjeve shtesë fizike të raporteve të progresit	4
5.1 (a)	Vlera maksimale e lejueshme e akumuluar e punës së nënkontraktuar (si përqindje e Shumës së Pranuar të Kontratës)	40%
5.1 (b)	Pjesë të Punimeve për të cilat nuk lejohet nënkontraktimi	• Dragimi • Bonifikimi duke përjashtuar furnizimin me materiale mbushëse • Dallgëthyes duke përjashtuar furnizimin me shkëmbinj. • Kalata
6.5	Orari normal i punës në kantier Dragimi & operacionet e lidhura	07:00 – 19:00 24 orë/ditë 7 ditë/javë
8.3	Numri i kopjeve shtesë fizike të programeve	4
8.8	Dëmshpërblimet nga vonesa të pagueshme për çdo ditë vonese	Tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës

		korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
8.8	Shuma maksimale e dëmshpërblimeve për vonesë	
12.2	Mënyra e matjes	
12.3	Fitimi në përqindje	Siç thuhet në pikën 1.1.20 më sipër
13.4 (b) (ii)	Norma e përqindjes që do të zbatohet për Shumat Provizore për tarifat e përgjithshme dhe fitimin	7,5%
14.2	Shuma totale e Paradhënies (si përqindje e Shumës së Pranuar të Kontratës)	15%
14.2	Monedha ose monedhat e Paradhënies	Lekë
14.2.3 (a)	Shuma minimale e pagesave të ndërmjetme të certifikuara për të filluar shlyerjen e Paradhënies (si përqindje e Shumës së Pranuar të Kontratës)	10%
14.2.3 (b)	Zbritjet në përqindje për shlyerjen e Paradhënies	25%
14.3	Periodha e pagesës	
14.3 (b)	Numri i kopjeve shtesë të Deklaratave	4
14.3 (iii)	Përqindja e mbajtjes	10%
14.3 (iii)	Kufiri i Shumës së Parave të Mbajtura (si përqindje e Shumës së Pranuar të Kontratës)	10%
14.5(b)(i)	Impiantet dhe materialet për pagesë kur dërgohen	Jo e zbatueshme
14.5(c)(i)	Impiantet dhe materialet për pagesë kur dorëzohen në kantier	Jo e zbatueshme
14.6.2	Shuma minimale e Certifikatës së Pagesës së Përkohshme (IPC)	50,000,000 Lekë
14.7 (a)	Periodha për pagesën e Paradhënies tek Kontraktori	

14.7 (b) (i)	Periudha për Punëdhënësin për të bërë pagesa të përkohshme tek Kontraktori sipas nën-klausolës 14.6 [<i>Pagesat e përkohshme</i>]	
14.7 (b) (ii)	Periudha për Punëdhënësin për të bërë pagesa të përkohshme tek Kontraktori sipas nën-klausolës 14.13 [<i>Pagesat përfundimtare</i>]	
14.7 (c)	Periudha për Punëdhënësin për të bërë pagesën përfundimtare tek Kontraktori	
14.8	Tarifat e financimit për pagesën e vonuar (pikë përqindjeje mbi normën mesatare të huadhënies afatshkurtër bankare siç referohet në nën-paragrafin (a))	Jo e zbatueshme
14.11.1 (b)	Numri i kopjeve shtesë fizike të draft Pasqyrës Përfundimtare	4
14.15	Monedhat për pagesën e Çmimit të Kontratës	Lekë
14.15(a)(i)	Përqindjet dhe shumat e monedhave vendase dhe të huaja janë: Lokale Të huaja	100% 0%
14.15 (c)	Monedhat dhe proporcionet për pagesën e Dëmshpërblimeve nga Vonesa	leke shqiptare
14.15 (f)	Kurset e këmbimit	Norma e Bankës së Shqipërisë fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës
17.2 (d)	Forcat e natyrës, risqet e të cilave i janë alokuar Kontraktorit	
19.1	Kufijtë e zbritshëm të lejuar • Siguracioni i duhur për Punët • Siguracioni i duhur për Mallrat • Siguracioni i duhur për përgjegjësinë për shkeljen e detyrimit profesional • Siguracioni i duhur kundër përgjegjësisë për përshtatshmërinë për qëllimin (nëse kërkohet) • Siguracioni i duhur për dëmtimin e personave, pronës, dhe ndotjen e mjedisit • Siguracioni i duhur për dëmtimin e punonjësve	

	Siguracioni për dragimin dhe impiantin pluskues/siguracioni për bykun dhe makineri/siguracioni për tranzitin detar Siguracione të tjera të duhura sipas ligjeve dhe nga praktika lokale Jo e zbatueshme	
19.2.1 (b)	Shuma shtesë për t'u siguruar (si përqindje e vlerës së zëvendësimit, nëse është më pak ose më shumë se 15%)	15%
19.2.1 (iv)	Lista e risqeve që rrjedhin nga ngjarje të jashtëzakonshme të cilat nuk do të përjashtohen nga mbulimi i siguracionit për Punët	
19.2.2	Shtrirja e siguracionit për Mallrat Shuma e siguracionit për Mallrat	
19.2.3 (a)	Shuma e siguracionit të duhur për përgjegjësinë për shkeljen e detyrimit profesional	
19.2.3 (b)	Siguracioni i duhur kundrejt përgjegjësisë për përshtatshmërinë	Jo e zbatueshme
19.2.3	Periudha e siguracionit të duhur për përgjegjësinë për shkeljen e detyrimit profesional	12 vjet
19.2.4	Shuma e siguracionit të duhur për dëmtimin e personave dhe dëmtimin e pronës	
19.2.6	Siguracione të tjera të duhura sipas ligjeve dhe praktikave lokale (jep detaje)	Jo e zbatueshme
21.1	Koha për emërimin e DAAB	28 ditë
21.1	DAAB do të përbëhet nga	3 anëtarë
21.1	Lista e anëtarëve të propozuar të DAAB-it - propozuar nga Punëdhënësi - propozuar nga Kontraktori	1..... 2..... 3..... 1..... 2..... 3.....
21.2	Subjekti emërues (zyrtar) për anëtarët e DAAB-it	

Përshkrimi i pjesëve të Punëve që do tu caktohet një Seksion për qëllimet e Kontratës (nën-klauzola 1.1.76) Vlera: Përqindja* e Shumës së Pranuar të Kontratës (nën-klauzola 14.9) Koha për Përfundimin (Nën-klauzola 1.1.86) Dëmshpërblimet për vonesën (Nën-klauzola 8.8)			
Jo e zbatueshme			

Shtojca 28.3 Kushte të Veçanta Pjesa B – Dispozita të Veçanta

Dispozitat që gjenden në Dispozitat e Veçanta (Kushtet e Veçanta - Pjesa B) kanë përparësi ndaj dispozitave ekuivalente që gjenden nën të njëjtin numër(a) të nën-klauzolës në Kushtet e Përgjithshme, dhe dispozitat e të Dhënave të Kontratës (Kushtet e Veçanta - Pjesa A) kanë përparësi ndaj Dispozitave të Veçanta (Kushtet e Veçanta - Pjesa B)

1.1.16 "Pajisjet e Kontraktorit"

Shtoni fjalët "mjet lundrues, objekte" pas "automjeteve".

1.7 Detyra:

Shtoni sa vijon pas fjalëve "sipas Kontratës" në rreshtin 2 të nën-klauzolës 1.7.

"as të marrë një partner ose partnerë të rinj dhe as t'i japë fund partneritetit që ekziston aktualisht midis tyre në lidhje me këtë Kontratë".

1.14 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare

Vendosni në fund të nën-klauzolës 1.14 të Kushteve të Përgjithshme:

d) në rastin e një Sipërmarrjeje të Përbashkët (SP), dy ose më shumë anëtarë nënshkruajnë një marrëveshje sipërmarrjeje të përbashkët për përmbushjen e detyrimeve të Kontraktorit sipas Kontratës. Kjo marrëveshje e sipërmarrjes së përbashkët pas miratimit nga Punëdhënësi do të jetë pjesë përbërëse e Kontratës.

Shtoni nën-klauzolat e reja të mëposhtme:

1.17 Vizatimet e projektit

Kontraktori realizon vizatimet e projektit që tregojnë Punën siç është kryer - duke përfshirë të dhënat më të plota të madhësive, niveleve, të gjitha dimensioneve dhe hapësirave, klasat e materialeve të përdorura realisht ose të përmbushura, etj. Këto skica do të realizohen herë pas here gjatë ecursisë së punës dhe tre kopje fizike të tyre do të dorëzohen tek Inxhinieri për verifikim. Kostoja e përgatitjes së këtyre skicave të projektit të punës siç është ekzekutuar realisht konsiderohet si e përfshirë në Shumën e Pranuar të Kontratës.

1.18 Kontraktori duhet të jetë në përputhje me ligjet

Kontraktori do të jetë në përputhje në të gjitha aspektet me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi dhe me rregulloret dhe/ose aktet nënligjore të çdo autoriteti vendor ose ligjor tjetër që mund të jenë të zbatueshme për Punët ose për çdo Punë ose Shërbim të Përkohshëm të përdorur si dhe rregullat e organeve dhe kompanive publike, dhe do ta zhdëmtojë Punëdhënësin kundrejt të gjitha penaliteteve dhe detyrimeve të çdo lloji për shkeljen e akteve, rregulloreve apo akteve nënligjore të zbatueshme.

2.4 Rregullimet Financiare të Punëdhënësit

Kjo nën-klauzolë do të fshihet

4.2 Sigurimi i Kontratës

Shtoni pas pikës së 2-të të nën-klausolës 4.2.1 Detyrimet e Kontraktorit:

Mos paraqitja e Sigurimit të Kontratës nga e Kontraktorit tek Punëdhënësi sipas kësaj nën-klausole përbën shkaqe të mjaftueshme për anulimin e kontratës dhe konfiskimin e Garancisë së Ofertës.

4.6 Bashkëpunimi

Në pikën (b), shtoni "dhe personelin dhe punëtorët e tyre" pas fjalës "nga Punëdhënësi".

4.7 Piketimi

Në fund të fjalisë së parë, shtoni sa vijon:

Kontraktori njofton Inxhinierin jo më pak se 24 (njëzet e katër) orë përpara lidhur me qëllimin e tij për piketimin ose dhënien e nivele për çdo pjesë të Punimeve, në mënyrë që të mund të merren masa në kohë për kontrollin ose lëshimin e udhëzimeve. Kontrolli i çdo piketimi ose i çdo linje ose niveli nga Inxhinieri ose Përfaqësuesi i Inxhinierit nuk e çliron në asnjë mënyrë Kontraktorin nga përgjegjësia e tij për korrektësinë e tij i cili gjithashtu do të mbrojë dhe ruajë me kujdes të gjitha pikat e piketimit, shufrat e nivelimit, kunjat dhe elementë të tjerë të përdorur në piketimin e punimeve.

Kontraktori nuk duhet të ndërhyjë pa lejen paraprake me shkrim të Inxhinierit asnjë shënjestër, pikë piketimi ose ndonjë shenjë tjetër referimi. Në rast se Kontraktori ka ndërhyrë në ndonjë shënjestër, pikë piketimi, apo ndonjë shenja të tjetra referimi të tillë, Kontraktori me shpenzimet e tij do të zëvendësojë dhe përmirësojë të njëjtë me miratimin e Inxhinierit.

4.10 Përdorimi i të dhënave të Kantierit

Shtoni në fund të fjalisë së fundit të pikës 1:

"dhe Punëdhënësi nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë ose vërtetësinë e të dhënave."

Në pikën 2, rreshti 1, fshini "(duke marrë parasysh koston dhe kohën)".

Shtoni nën-pikën e re:

(f) natyrën dhe vendndodhjen e shërbimeve ekzistuese (si mbi tokë ashtu edhe nën tokë) në kantier.

Punëdhënësi (ose çdo konsulent ose kontraktor i angazhuar prej tij) nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi dhe nuk jep garanci (të shprehura ose të nënkuptuara) për saktësinë ose plotësinë e çdo të dhëne të kantierit ose të ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me kantierin ose Punët ose që i vihen në dispozicion Kontraktorit në përputhje me këtë nën-klauzolë.

Kontraktori do të konsiderohet se ka bërë parashikime për të gjitha risqet dhe kontingjencat në lidhje me pengesat artificiale ose nën-sipërfaqësore ose nënujore ose kushte të tjera fizike, pavarësisht nëse kanë qenë të parashikueshme në datën e Kontratës ose jo.

Kontraktori nuk do të ketë të drejtë për ndonjë pagesë shtesë ose rritje të çmimit të Kontratës ose për ndonjë zgjatje kohore që rrjedh nga ose në lidhje me ndonjë pengesë ose kusht të tillë.

4.11 Mjaftueshmëria e Shumës së Pranuar të Kontratës

Në nën-pikën (a), shtoni "përpara tenderimit" pasi "kanë përmbushur vetë" dhe shtoni "të ofertës së tij për Punët dhe tarifat dhe çmimet e deklaruara në Tabelat e Çmimeve" dhe pas "korrektësia dhe mjaftueshmëria".

Në nën-pikën (b) shtoni "normat dhe çmimet e deklaruara në Tabelat e Çmimeve dhe Tabelën e Tarifave" dhe pas "kanë bazuar"

Në pikën 2 të nën-klauzolës, shtoni "normat dhe çmimet e deklaruara në Tabelat e Çmimeve dhe Tabelën e Tarifave" dhe para "Shumës së Pranuar të Kontratës"

Shtoni pikat e mëposhtme pas pikës 2:

Tarifat dhe çmimet e përmendura nga Kontraktori në Tabelat e Çmimeve dhe Tabelën e Tarifave përfshijnë pagat, transportin, akomodimin, sigurimet, shtesat e të gjitha llojeve dhe të gjitha shpenzimet, kostot dhe tarifat çfarëdo që mund t'i kërkojnë Kontraktorit të kryejë për respektimin e dispozitave të të gjitha rregulloreve dhe akteve të përmendura në nën-klauzolën 6.4, dhe në lidhje me Përfaqësuesin e Kontraktorit dhe punonjësit e tjerë si dhe fuqinë punëtore dhe pagesën e të gjitha tarifave, dhe renta e tjera, qirasë dhe pagesat ose kompensimet tjera (nëse ka) për sigurimin e gurit, rërës, zhavorrit ose materialeve të tjera, taksa terminale ose e shitjes, tatimin mbi të ardhurat, detyrimet e importit dhe tarifat, detyrimet dhe taksat e tjera që duhen paguar sipas akteve të Qeverisë së Shqipërisë ose rregulloreve apo akteve nënligjore të çdo autoriteti vendor ose të çdo autoriteti tjetër ligjor në lidhje me materialet, punën, impiantin dhe të gjitha gjërat e tjera të marra ose të përdorura prej tij për kryerjen e Punëve ose Punëve të Përkohshme.

4.13 Zona e zhvillimit dhe Facilitetet

Në rreshtin 5, shtoni "dhe/ose akomodimi" pas "facilitete"

4.14 Shmangia e Ndërhyrjes

Shtoni "gjatë të gjitha operacioneve të nevojshme për ekzekutimin dhe përfundimin e Punëve dhe korrigjimin e çdo defekti në to dhe ndërtimin e çdo Pune të Përkohshme" midis "Kontraktorit" dhe "nuk do të ndërhyjë" në rreshtin 1 të kësaj nën-klauzole.

Shtoni "rrugët ujore" pas "rrugëve" në (b).

Shtoni pikat e reja të mëposhtme në fund të pikës 2 ekzistuese.

Punët dhe Punët e Përkohshme kryhen në mënyrë të tillë që të mos ndërhyjnë në funksionimin normal të Punëdhënësit. Për të siguruar këtë:

- (a) Punëdhënësi i ofron Kontraktorit lehtësira të arsyeshme për t'i mundësuar atij të zbatojë Kontratën, por Kontraktori duhet të respektojë rreptësisht çdo rregull, rregullore ose udhëzim që ai mund të marrë herë pas here nga Punëdhënësi ose Inxhinieri ose çdo person ose persona të autorizuar nga ato për sigurinë dhe mbrojtjen e personave dhe pronës në kantier.
- (b) Kontraktorit i lejohet vetëm zënia e zonave tokësore dhe detare dhe përdorimi i rrugëve në masën e përcaktuar në Specifikimet ose të rëna dakord nga Punëdhënësi ose në atë masë të mëtejshme që mund të lejohet me shkrim nga Inxhinieri.

Përveç sa më sipër, Kontraktori në kryerjen e Punimeve dhe Punimeve të Përkohshme nuk do të ndërhyjë në mënyrë të panevojshme ose të parregullt në:

- (aa) kanalën e kullimit dhe daljen e detit ngjitur me skarpatën mbrojtëse në anën jugore të basenit lindor, dhe të shmangë çdo humbje, dëmtim ose çdo ndërprerje të operacioneve të tij;
- (bb) aksesin dhe përdorimin e molit dhe ankoruesit të AV gazit në anën lindore të Dallgëthyesit Jugor dhe për të shmangur çdo humbje, dëmtim ose çdo ndërprerje të operacioneve të tij; dhe
- (cc) aksesin dhe përdorimin e tubacionit nëndetar menjëherë në det të hapur të Dallgëthyesit Jugor dhe të shmangë çdo humbje, dëmtim ose çdo ndërprerje të operacioneve të tij.

Për më tepër, Kontraktori në kryerjen e Punimeve dhe Punimeve të Përkohshme, me shpenzimet e tij, dhe duke marrë përsipër riskun, respekton dhe zbaton kufizimet e mëtejshme në lidhje me kryerjen e Punimeve dhe Punimeve të Përkohshme të përcaktuara në Specifikimet ose të vendosura nga Autoriteti Portual, autoritetet përkatëse kompetente ose ndonjë palë tjetër e tretë.

Nëse ekzekutimi i Punimeve dhe Punimeve të Përkohshme ndërhyr ose mund të pritët në mënyrë të arsyeshme të ndërhyjë në ndonjë nga operacionet e përcaktuara më sipër (përfshirë por pa u kufizuar në operacionet e ndonjë pale të tretë), Kontraktori njofton Inxhinierin dhe respekton udhëzimet përkatëse të Inxhinierit të dhëna me qëllim përfundimin, reduktimit ose shmangien e një ndërhyrjeje të tillë.

Kur ekzekutimi i Kontratës kërkon devijimin, pengimin ose mbylljen e ndonjë rruge, hekurudhe ose rruge ujore ose ndonjë të drejtë tjetër kalimi, Kontraktori do të marrë miratimin paraprak me shkrim nga Inxhinieri (pas konsultimit me Punëdhënësin) dhe autoritetet kompetente përkatëse.

Informacioni i tillë që mund të jepet në Kontratë për gjendjen dhe karakterin aktual të strukturave ekzistuese, rrugëve, argjinaturave dhe të ngjashme, si dhe për formën dhe dimensionet e strukturave ekzistuese dhe për pozicionet dhe veçoritë e kanaleve kulluese, tubacioneve, kabllave dhe të ngjashme, qofshin nën ose mbi tokë, nën ujë ose nën shtratin e detit, jepen pa asnjë garanci për saktësinë dhe as Punëdhënësi dhe as Inxhinieri nuk do të jenë përgjegjës për ndonjë mospërputhje në to, përveç rastit kur një informacion i tillë është pjesë e të dhënave të kantierit. Kontraktori përmbush vetë kushtet sa i takon vendndodhjes dhe gjendjes së çdo shërbimi që kërkon mbështetje, devijim ose zëvendësim për të mundësuar përfundimin e Punimeve dhe Punimeve të Përkohshme.

Kapiteni i portit, në interes të lundrimit të sigurt dhe operacioneve portuale, mundet të lëshojë një njoftim për të pezulluar operacionet në zonën e caktuar. Kur udhëzohet kështu nga kapiteni i portit, Kontraktori pezullon operacionet e tij dhe ose qëndron në pritje ose vijon me operacionet në një zonë tjetër që mund të udhëzohet nga Inxhinieri derisa të jepet leja nga kapiteni i portit ose Inxhinieri për rifillimin e operacionit të pezulluar.

Kontraktori kryen Punimet e tij në një mënyrë e cila nuk pengon ose rrezikon përdorimin e rrugëve ujore, ankorimeve, skelave dhe rrugën drejt tyre, qofshin në zotërim të Punëdhënësit, Autoritetit Portual ose ndonjë personi tjetër.

Kontraktori nuk do të ndërhyjë në asnjë punë ose operacion të lidhur me portin që kryhet nga ndonjë agjenci ose personel i autorizuar në port dhe as nuk do të mohojë aksesin në personelin dhe automjetet e tyre ose ndonjë person, klient ose agjenci tjetër që ka të bëjë me ta.

Kontraktori e zhdëmton dhe e mban Punëdhënësin të padëmtuar kundrejt të gjitha pretendimeve dhe humbjeve të shkaktuara apo që lindin kundrejt një pale të tretë nga lëndimet trupore, sëmundja, vdekja ose dëmtime, shkatërrimi ose humbja e pronës së palës së tretë, në masën që rezulton apo i atribuohet ndonjë veprimi ose mosveprimi të Kontraktorit në lidhje me këtë nën-klauzolë.

Pavarësisht nga sa më sipër, Kontraktori heq dorë nga të gjitha pretendimet kundër Punëdhënësit që lindin në lidhje me respektimin nga ana e tij të kërkesave të përshkruara në këtë nën-klauzolë, nëse këto pretendime do të lindnin edhe sipas Kontratës ose ndonjë parimi ose teorie tjetër të ligjit.

4.15 Rruga e hyrjes

Shtoni në fund të fjalisë së parë:

"(duke përfshirë pa kufizim, çdo rrugë detare ose rrugë të tjera të lundrueshme të hyrjes dhe të gjitha kufizimet në përdorimin e tyre.)"

Shtoni sa vijon në fund të nën-klauzolës ekzistuese 4.15:

Kontraktori përdor çdo mjet të arsyeshëm për të parandaluar dëmtimin e ndonjë prej autostradave, rrugëve ose urave që komunikojnë me ose në rrugët drejt kantierit nga trafiku i Kontraktorit ose ndonjë prej nënkontraktorëve të tij dhe në veçanti zgjedh rrugët, si dhe zgjedh dhe përdor automjete dhe kufizo dhe shpërndan ngarkesat në mënyrë që lëvizja e materialeve, impiantit, pajisjeve të kontraktorit etj., për në kantier dha jashtë tij të mos dëmtojë këto autostrada, rrugë dhe ura.

Nëse ndonjë autostradë, rrugë apo urë dëmtohet nga një trafik i tillë siç u përmend më lart, atëherë:

- (a) Nëse autostrada, rruga ose ura i është dhënë si e drejtë ose mirëmbahet nga Punëdhënësi, Kontraktori me shpenzimet e tij ndreq të gjitha këto dëme në mënyrë të kënaqshme për Punëdhënësin ose nëse Punëdhënësi preferon ta kryejë vetë ndreqjen, Kontraktori do t'i paguajë atij shpenzimet e nevojshme ose Punëdhënësi mund t'ia zbresë ato nga shuma që i detyrohet Kontraktorit ose në forma të tjera të marrë prej tij shpenzimet e kryera për të ndrequr autostradën, rrugën ose urën që i atribuohen dëmit të shkaktuar nga ose për shkak të trafikut të tillë për sa më sipër.
- (b) Në çdo rast tjetër, Kontraktori dëmshpërblen dhe mban të dëmshpërblyer Punëdhënësin dhe është vetë përgjegjës si dhe përmbush dhe shkarkon të gjitha pretendimet, kërkesat, procedurat, dëmet dhe shpenzimet në lidhje me çdo dëmtim të tillë të autostradës, rrugës ose urës(ave). Në rast të mos zgjidhjes së pretendimit nga ana e Kontraktorit dhe në rast se Punëdhënësi mbahet përgjegjës për pagesën ndaj autoriteteve, atëherë Punëdhënësi e zgjidh pretendimin dhe shpenzimet e tij në këtë drejtim, siç vërtetohen nga Inxhinieri, do t'i zbriten detyrimeve të tij ndaj Kontraktorit.

Kur natyra e Punimeve është e tillë që kërkon përdorimin nga Kontraktori të transportit ujor, dispozitat e mësipërme të kësaj klauzole do të interpretohen sikur 'autostrada' përfshin një portë ujore, mol, mur detar ose strukturë tjetër që lidhet me një rrugë ujore dhe 'automjet' përfshijnë mjetin lundrues dhe do të zbatohen sipas rrethanave.

Pas nën-klauzolës 4.23 shtoni nën-klauzolat e reja të mëposhtme:

4.24 Publiciteti

Kontraktori nuk do të lejojë që asnjë informacion në lidhje me Punët e përfshira këtu të botohet në ndonjë gazetë shkencore, inxhinierike ose në ndonjë gazetë, periodike, tregtare ose botime të tjera, përfshirë faqet e internetit, pa lejen paraprake me shkrim të Punëdhënësit.

4.25 Angazhimi i Kontraktorit

Kontraktori merr përsipër Dokumentet e Kontraktorit, Punët e ekzekutuara dhe të përfunduara do të jenë në përputhje me:

- (a) ligjet e vendit, dhe
- (b) dokumentet që janë pjesë përbërëse e Kontratës, të ndryshuar ose modifikuar nga Ndryshimet.

5.1 Nënkontraktorët

Shtoni artikuj të rinj si më poshtë:

- (c) asnjë veprim i ndërmarrë nga Punëdhënësi sipas kësaj nën-klauzole nuk e çliron Kontraktorin nga ndonjë prej detyrimeve të tij sipas Kontratës apo sjell ndonjë dëmshpërblim, zgjatje kohore ose tjetër.
- (d) Kontraktori do të jetë përgjegjës për ftesën për oferta, finalizimin e tenderëve, koordinimin dhe mbikëqyrjen e punës së Nënkontraktorit.
- (e) Vetë Kontraktori do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e Punëve dhe korrigjimin e çdo defekti të kryer nga nënkontraktorët gjatë periudhës së njoftimit të defekteve.

Fshini pikën 2 dhe shtoni sa vijon;

“Kontraktori është dhe mbetet përgjegjës i vetëm për punën e të gjithë nënkontraktorëve, për menaxhimin dhe koordinimin e të gjitha punëve të nënkontraktorëve, dhe për cilësinë dhe ekzekutimin e duhur të shpejtë të punëve, përmbushjen e të gjitha kushteve të Kontratës në të gjitha aspektet dhe veprimet ose mospërmbushjet e çdo nënkontraktori, çdo agjenti ose punonjësi të nënkontraktorit, sikur të ishin veprimet ose mospërmbushjet e vetë Kontraktorit sikur një nënkontraktim i tillë të mos kishte ndodhur, dhe sikur një punë e tillë të ishte kryer drejtpërdrejt nga Kontraktori.

6.4 Ligjet e Punës

Shtoni sa vijon pas pikës së fundit:

"Kontraktori është përgjegjës për të siguruar që të gjithë nënkontraktorët të jenë në përputhje me dispozitat e mësipërme."

6.7 Shëndeti dhe Siguria

Në pikën 1, rreshti 3, shtoni pas "Personelit të Kontraktorit" sa vijon:

"dhe të respektojë ose të sigurojë respektimin e të gjitha rregullave dhe rregulloreve të autoriteteve lokale shëndetësore dhe të autoriteteve të tjera ose siç përcaktohet nga Punëdhënësi herë pas here për mbrojtjen e shëndetit dhe masave për shëndetin e të gjithë punëtorëve."

Shtoni sa vijon pas pikës 2:

Në lidhje me Punët, Kontraktori siguron dhe mirëmban me shpenzimet e tij të gjitha dritat, rojet, rrethimet, dritat paralajmëruese, shenjat paralajmëruese dhe

mbikëqyrjen, dhe ku është e nevojshme ose kërkohet nga Inxhinieri ose Përfaqësuesi i Inxhinierit ose nga ndonjë autoritet i krijuar rregullisht për mbrojtjen e Punëve ose për sigurinë dhe komoditetin e publikut ose të tjerëve.

6.8 Mbikëqyrja Kontraktorit.

Në (a), rreshti 2, pas "për komunikime" shtoni "dhe për marrjen dhe dhënien e udhëzimeve, kuptimin e Specifikimeve, skicave dhe udhëzimeve dhe vendimeve të tjera dhe mbajtjen e korrespondencës në kantier".

Pas nën-klauzolës 6.12 shtoni nën-klauzolat e reja në vijim

6.13 Personeli i huaj

Kontraktori mund të sjellë në vend personel të huaj që është i nevojshëm për ekzekutimin e Punëve në masën e lejuar nga ligjet në fuqi. Kontraktori siguron që ky personel të pajiset me vizat e nevojshme të qëndrimit dhe lejet e punës. Punëdhënësi, nëse kërkohet nga Kontraktori, bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme në kohën e duhur dhe në mënyrë të shpejtë për të ndihmuar Kontraktorin në marrjen e lejeve lokale, kombëtare ose qeveritare të nevojshme për të sjellë personelin e Kontraktorit.

Kontraktori është përgjegjës për kthimin në vendin nga ku janë rekrutuar ose në vendbanimin e tyre. Në rast të vdekjes në vend të personelit të huaj ose ndonjë anëtar i të familjeve të tyre, Kontraktori është po ashtu përgjegjës për marrjen e masave të duhura për kthimin ose varrimin e tyre.

6.14 Pijet alkoolike ose droga

Kontraktori, përveç se në përputhje me ligjet e vendit, nuk importon, shet, dhuron, shkëmben apo asgjëson pije alkoolike ose drogë, apo lejon importimin, shitjen, dhurimin, shkëmbimin ose asgjësimin e tyre nga personeli ose nënkontraktorët e tij.

6.15 Armët dhe municionet

Kontraktori nuk jep, shkëmben apo i tjetërsion ndonjë personi, asnjë armë ose municione të çfarëdo lloji, dhe nuk lejon as personelin e tij ta bëjë këtë.

6.16 Festat dhe zakonet fetare

Kontraktori respekton festat e njohura të vendit, ditët e pushimit dhe zakonet fetare ose të tjera.

6.17 Furnizimi me ujë

